



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 gusht 2024  
Nr. ref.: RK 2502/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr.KI67/24**

Parashtrues

**Nail Kryeziu, Neze Shalaj, Samir Krasniqi, Gjylbear Hyseni, Xhavit Mala, Besim Kolgeci, Bajram Kafexholli, Hasim Kryeziu, Fitor Hoxha, Faridin Hasanagic, Bekim Bytyqi, Zafir Azizovic, Rafit Kurtisi, Iljaz Nesho dhe Nehat Purova**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Pyje (nr. 08/L-137), i publikuar më 3 prill 2023 në Gazetën Zyrtare**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

### **Parashtruesit e kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Nail Kryeziu, Samir Krasniqi (nga fshati Brezne, Komuna e Dragashit), Neze Shalaj, Gjylbear Hyseni, Xhavit Mala, Bekim Bytyqi, Iljaz Nesho, Zafir Azizovic, Nehat Purova (nga Prizreni,) Besim Kolgeci (nga fshati Vraniq, Komuna e Suharekës), Bajram Kafexholli, Fitor Hoxha (nga fshati Bellanicë, komuna e Prishtinës), Hasim Kryeziu (nga Komuna e Dragashit), Faridin Hasanagic (nga fshati Manastirice, Komuna e Prizrenit) dhe Rafit Kurtisi (nga fshati Donje Ljubinjë, Komuna e Prizren) (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Nazmi Mustafi, avokat nga Prizreni.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit për Pyje, përkatësisht të Ligjit Nr. 08/L-137 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Kontestuar), përkatësisht paragrafit (2) të nenit 2; paragrafit (1) të nenit 8; neni 27; paragrafit (6) të nenit 33; paragrafit (8) të nenit 49; paragrafit (3) të nenit 58, paragrafit (4) i nenit 64; nënparagrafët (1.1) dhe (1.2) të nenit 67; paragrafin (3) të nenit 76 të po këtij Ligji, përmes së cilave parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në përputhje me nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimi të Profesionit], 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], 80 [Miratimi i Ligjeve], 81 [Legjislacioni me Interes Vital], 121 [Prona], 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, përkatësisht paragrafit (2) të nenit 2; paragrafit (1) të nenit 8; neni 27; paragrafit (6) të nenit 33; paragrafit (8) të nenit 49; paragrafit (3) të nenit 58, paragrafit (4) i nenit 64; nënparagrafët (1.1) dhe (1.2) të nenit 67; paragrafin (3) të nenit 76 të këtij ligji.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 18 mars 2024, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
6. Më 26 mars 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr.GJR. KI67/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban si Gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr.KSH.KI 67/24] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
7. Më 12 prill 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, duke e njoftuar se e ka regjistruar atë në regjistrin përkatës të Gjykatës, me numrin KI67/24.
8. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve të rastit**

9. Parashtruesit e kërkesës janë të punësuar në Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri", me seli në Prizren, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

10. Më 6 korrik 2022, njëri nga parashtruesit e kërkesës B.K. kishte dërguar përmes postës elektronike një *“Kërkesë për ndryshime dhe amandamentim të Propozim Ligjit për Pyjet”*, të cilën iu kishte dërguar: (i) Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani; (ii) Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti; (iii) Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca; (iv) z. Abelard Tahiri; (v) znj. Fitore Pacolli; (vi) z. Bajram Badivnuku; (vii) znj. Mimoza Kusari- Lila; (viii) z. Arben Gashi; (ix) z. Besnik Tahiri; (x) z. Igor Simic; (xi) z. Enis Kervan; si dhe (xii) Zyrës për Komunikim Publik. Në këtë kërkesë, B.K. shprehu shqetësimin në lidhje me ligjin e kontestuar dhe ofroi propozime për ta ndryshuar atë, duke marrë për bazë përvojat dhe legjislacionin e vendeve nga Evropa.
11. Më 21 mars 2023, njëri nga parashtruesit e kërkesës B.K kishte dërguar përmes postës elektronike një *“Kërkesë për harmonizimin e Ligjit për Pyjet me kushtetutën dhe legjislacionin për Parqet Kombëtare”*, të cilën iu kishte dërguar: (i) Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani; (ii) Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti; si dhe (iii) Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se:
- “[...] Ju njoftojmë së përbërja e këtij Ligji në nenin 2, paragrafi 2, nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, nenin 28, neni 34, paragrafi 6, neni 50, paragrafi 8, neni 68 dhe nën paragrafët 1.1 dhe 1.3, neni 70, paragrafi 1, që kanë kaluar leximin e parë në muajin korrik 2022 kanë qenë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 122, paragrafi 2) dhe legjislacionin për mbrojtjen e natyrës dhe Parqet Kombëtare: Ligji për Mbrojtjen e Natyrës. Ligji Nr 03/L-233; Ligji për Parkun Kombëtar Sharri, Ligji nr.04/L-087; Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” Ligji nr. 04/L-086; Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri” – Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-V-772; Rregullorja e MMPH për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare nr. 21/2013 GZ Nr. 46/08 nëntor 2013 etj.”*
12. Më 9 mars 2023, Ligji i Kontestuar është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).
13. Më 03 prill 2023, Ligji i Kontestuar është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
14. Më 12 prill 2023, dy nga parashtruesit e kërkesës, B.K. dhe F.M, në cilësinë e drejtorit të DAPK “Sharri” respektivisht DAPK “Bjeshkët e Nemuna”, parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme dhe te Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke pretenduar se ligji i kontestuar përmban shkelje kushtetuese dhe ligjore dhe kërkuan që ligji i kontestuar të pezullohet apo ndryshohet në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për parqet kombëtare.
15. Po të njëjtën datë, parashtruesit e kërkesës i kishin parashtruar ankesë: (i) Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; (ii) Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës; (iii) Gjykatës Supreme; (iv) Kryesuesit të KGJK-së; (v) Presidentes së Republikës së Kosovës; (vi) Kryeministrit të Republikës së Kosovës; (vii) Kryetarit të Kuvendit; (viii) Kryetares së Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim; (ix) Koordinatorit të Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim; (x) znj. Mimoza Kusari-Lila, Shefe e Grupit Parlamentar te LVV; (xi) z. Abelard Tahiri, Shef i Grupit Parlamentar i PDK; (xii) z. Arben Gashi, Shef i Grupit Parlamentar i LDK; (xiii) z. Besnik Tahiri, Shef i Grupit Parlamentar i AAK; (xiv) z. Igor Simiq, Shef i Grupit Parlamentar i LS; si dhe (xv) z. Enis Kervan, Shef i Grupit Parlamentar Multietnik.

16. Më 07 nëntor 2023, gjashtë (6) nga parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar një kërkesë në DAPK "Sharri", që si pronarë të pronës private që gjendet në territorin e Parkut Kombëtar Sharri, gjegjësisht në Zonën Kadastrale Mushnikovë, t'u ipet mundësia e shfrytëzimit të pyjeve private të vendosura për nevoja familjare dhe me qëllim furnizimin e komunitetit lokal me dru zjarri për sezonin e dimrit. Parashtruesit e kërkesës i kishin bashkangjitur kërkesës së tyre fletat e pronësisë dhe kopjet e planeve, përmes së cilave vërtetohet se janë të vetmit pronarë të njësisë kadastrale në zonën përkatëse.
17. Më 16 tetor 2023, DAPK-ja refuzoi kërkesat e parashtruesve të kërkesës për mundësimin e shfrytëzimit të pyjeve private që gjenden në Parkun Nacional "Sharri" për nevoja familjare: DAPKSH-ja arsyetoi si në vijim: *"[...] duke pasur parasysh se në këtë vit (2023), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MZSPPI), gjegjësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) nuk ka dhënë leje (ka marr vendim) për zbatimin e planit vjetor për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve në Parkun Kombëtar "Shari", me Njoftim se sivjet nuk mund të kryhen shërbimet prerje sanitare në pyje publike dhe private me qëllim të furnizimit të komunitetit lokal me dru zjarri për sezonin e dimrit, për shkak të ndërhyrjeve të Agjencisë Pujore të Kosovës dhe ndërhyrjeve në juridiksionin e Ligjit për Pyjet nr. 08/L-137 i cili është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Presidenca [...].*

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

18. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në përputhje me nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], 80 [Miratimi i Ligeve], 81 [Legjislacioni me Interes Vital], 121 [Prona], 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës.
19. Parashtruesit e kërkesës nuk e kontestojnë në tërësi Ligjin e kontestuar por vetëm dispozitat si në vijim: paragrafin (2) të nenit 2; paragrafin (1) të nenit 8; neni 27; paragrafin (6) të nenit 33; paragrafi (8) i nenit 49; paragrafi (3) i nenit 58, paragrafi (4) i nenit 64; nënparagrafët (1.1) dhe (1.2) të nenit 67; paragrafin (3) të nenit 76.
20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji i kontestuar nuk është në përputhje me legjislacionin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Parqet Kombëtare si: (i) Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës; (ii) Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri"; (iii) Ligji Nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"; (iv) Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri", respektivisht Vendimi i Kuvendit me numër 04-V-772; (v) Rregulloren e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare me numër 21/2013.
21. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, Ligji i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për parqet kombëtare, sipas së cilave parqet kombëtare janë zona të mbrojtura me rëndësi nacionale që rregullohen me legjislacion të veçantë. Parashtruesi e kërkesës theksojnë se sipas nenit 122, paragrafit 2 të Kushtetutës, vlerat e natyrës me rëndësi dhe interes nacional siç janë parqet kombëtare rregullohen me ligj të veçantë, si Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri" dhe Ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë në pajtim me ligjin. Rrjedhimisht, sipas tyre, çdo ligj tjetër që hartohet dhe aprovohet në Kuvend duhet të përputhet me legjislacionin e lartcekur.

22. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se, neni 27 i Ligjit të kontestuar parasheh hartimin e planit për menaxhimin e pyjeve në Parkun Kombëtar që hartohet dhe zbatohet nga Agjencia Pyjore, gjë që është në kundërshtim me legjislacionin ekzistues për mbrojtjen e natyrës dhe Parqet Kombëtare, i cili parasheh Planin Hapësinor dhe Planin e Menaxhimit për Parqet Kombëtare ku përfshihet menaxhimi i të gjitha vlerave dhe resurseve natyrore. Kompetentë për hartimin dhe zbatimin e Planit menaxhues të Parkut Kombëtar, Programeve dhe Planeve vjetore për pyjet dhe resurset tjera natyrore në Parkun Kombëtar është Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar, e jo Agjencia e Pyjeve siç përcaktohet nga Ligji i kontestuar.
23. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se, neni 69 i Ligjit të kontestuar parasheh vendosjen e “shërbimit për ruajtjen e pyjeve” nga Agjencia Pyjore në pyjet dhe tokat pyjore shtetërore, që nënkupton edhe në Parqet Kombëtare, gjë që është në kundërshtim me legjislacionin aktual të lartcekur, që definon se mbikëqyrjen dhe ruajtjen e të gjitha resurseve natyrore në Parqet Kombëtare e kryejnë mbikëqyrësit dhe rojtarët e natyrës së Drejtorisë e cila menaxhon me Parkun Kombëtar dhe jo rojtarët e pyjeve të Agjencionit të Pyjeve.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 7 [Vlerat]**

1. *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.  
[...]*

#### **Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]**

1. *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.  
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.  
[...]*

#### **Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]**

1. *“E drejta e pronës është e garantuar.  
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.  
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.  
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.  
[...]*

**Neni 52**  
**[Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]**

1. "Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.
2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.
3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve."

**Neni 80**  
**[Miratimi i Ligjeve]**

1. "Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.  
[...]

**Neni 121**  
**[Prona]**

1. "Llojet e pronës rregullohen me ligj.  
[...]

**Neni 122**  
**[Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]**

1. "Populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.
2. Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.
3. Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksplotimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj."

**Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

24. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Rregulli 34

(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar;

27. Duke iu referuar dispozitave të lartpërmendura, Gjykata duhet që fillimisht të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë.
28. Gjykata rithekson se, Kushtetuta nuk parashikon mundësinë që individët të kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të përgjithshme, nëse ato janë në përputhje me Kushtetutën. Individët janë të autorizuar të kontestojnë vetëm aktet e autoriteteve publike, të cilat i cenojnë të drejtat e tyre të përcaktuara me Kushtetutë (shih, rastet e Gjykatës, [KI102/17](#), parashtrues Meleq Imeri, Aktvendim për papranueshmëri i 10 janarit 2018, paragrafi 20; [KI92/12](#), parashtrues Sali Hajdari, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2012, paragrafi 16; [KI17/19](#), parashtrues Zymer Neziri, Rexhep Doçi, Daut Bislimi, Xheladin Shala, Adem Zejnullahu, Exhlale Dobruna, Mehmet Ahmetaj, Aktvendim për papranueshmëri i 9 korrikut 2020, paragrafët. 33-34; rasti i GJEDNJ-së, [Centre for Legal 4 Resources on Behalf of Valentin Campeanu kundër Romanisë](#), nr. 47848/08, Aktgjykimi i 17 korrikut 2014, paragrafi 101).
29. Gjykata rithekson se, në rastet kur individët argumentojnë se një ligj i ka prekur drejtpërdrejtë interesat e tyre juridike dhe ekzistojnë vendime zbatuese të mbështetura në atë ligj, atëherë Gjykata i pranon si palë të autorizuar (shih, rasti i Gjykatës, [KI185/21](#), parashtrues SHPK “CO COLINA”, Aktgjykimi i 8 shkurtit 2023, paragrafët. 103-111). Në rastet kur ekzistojnë vendimet zbatuese të mbështetura në ligj me të cilat preken të drejtat juridike të individëve, dhe këta të fundit nuk i përdorin mjetet juridike pranë gjykatave të rregullta kundër atyre vendimeve, Gjykata i konsideron këto kërkesa

- si të parakohshme (shih, rasti i Gjykatës, [KI136/19](#), *parashtrues SHPK "CO COLINA"*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 prillit 2021, paragrafi. 93-96).
30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar u miratua nga Kuvendi më 9 mars 2023, ndërsa u publikua në Gazetën Zyrtare më 3 prill 2023.
  31. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar, me pretendimin se disa dispozita të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon çështjet e mjedisit. Parashtruesit e kërkesës kishin drejtuar shkresa tek institucionet kryesore të shtetit, duke i adresuar pretendimet e tyre se Ligji i kontestuar nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Mesa duket, shqetësimet dhe pretendimet e tyre nuk ishin marrë parasysh dhe nuk ishin reflektuar në Ligjin e kontestuar.
  32. Gjykata vëren se, disa nga parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar një kërkesë në DAPK "Sharri", që si pronarë të pronave private që gjenden në territorin e Parkut Kombëtar Sharri, të shfrytëzonin pyjet private për nevoja familjare dhe për furnizimin e komunitetit lokal me dru zjarri për sezonin e dimrit (shih paragrafin 16). Kërkesa e tyre u refuzua nga DAPK "Sharri" me arsyetimin se, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës kishte nxjerrë vendim për mos lejimin e prerjes në pyje publike dhe private për qëllime të furnizimit të komunitetit lokal me dru zjarri për sezonin e dimrit (shih paragrafin 17).
  33. Gjykata thekson se, vendimi i DAPK "Sharri" për refuzimin e kërkesës së parashtruesve të kërkesës për përdorimin e pyjeve private për nevojat e tyre, përbën një akt, vendim apo masë zbatuese të cilat kanë shërbyer për të zbatuar Ligjin e kontestuar. Parashtruesit e kërkesës kanë pasur mundësi që të përdorin mjetet juridike në dispozicion për të kundërshtuar vendimin e lartcekur; dhe për t'i realizuar interesat e tyre juridike pranë gjyqësorit të rregullt. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar që kanë përdorur ndonjë mjet juridike pranë gjykatave të rregullta në lidhje me këtë çështje (shih, rastin e Gjykatës, [KI136/19](#), *parashtrues SHPK "CO COLINA"*, cituar më lart, para. 89-97).
  34. Gjykata përsërit se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që do të thotë se individët nuk mund të ankohen në abstrakt apo të kontestojnë veprimet apo aktet e organeve publike. Kushtetuta e Kosovës parasheh ankesën e individëve lidhur me veprimet e organeve publike vetëm në kuadër të fushëveprimit të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me të cilët kërkohet nga parashtruesit që të dëshmojnë se janë (1) palë të autorizuar, (2) se janë prekur drejtpërdrejt nga akti konkret apo lëshimi i organeve publike, dhe (3) se i kanë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj (shih, rastin e Gjykatës, [KI39/11](#), *parashtrues Tomë Krasniqi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit nr. 311/07 të datës 13 prill 2007, dhe Vërtetimit nr. 322/07 të datës 30 prill 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mbrojtjes Sociale, Aktvendim për Papranueshmëri i datës 30 janar 2013, paragrafi 40 dhe referencat e cituara aty).
  35. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se kompetencë procedurale dhe materiale për të kërkuar vlerësimin e aktit të natyrës së përgjithshme mund të ushtrojnë vetëm institucionet kushtetuese, në përputhje me procedurën e përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës; përderisa individët kanë të drejtë të kontestojnë vetëm aktet individuale të organeve publike, me të cilat shkelen të drejtat e tyre individuale dhe atë pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës.



36. Në përputhje me këtë, kërkesa duhet të shpallet e papranueshme në baza kushtetuese, për shkak se nuk është parashtruar në mënyrë të ligjshme nga ana e palës së autorizuar, siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës.
37. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë të autorizuar sipas paragrafit 1 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullit 34 (1) (a) të Rregullores së punës, andaj kërkesa duhet të shpallet e papranueshme.


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (a) të Rregullores së Punës, më 16 korrik 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA DËRGOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**



Radomir Laban

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani